

L I G J
Nr.9061, datë 8.5.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR
PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË
FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, NDRYSHUAR ME
LIGJIN NR.8500, DATË 10.6.2000**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8500, datë 10.6.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 pika 9 bëhen këto ndryshime:

- në shkronjën “a” shtohen fjalët: “Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryetari i Arbitrazhit të Lartë Shtetëror”;
- në shkronjën “a”, pas fjalëve “këshillave të rretheve” shtohen fjalët “këshillave të qarqeve”;
- në shkronjat “a” dhe “b”, pas fjalëve “institucione qendrore” shtohet fjala “buxhetore”;
- në shkronjat “c” dhe “d”, kudo ku janë përmendur fjalët “funksion dhe pagë”, hiqet fjala “pagë”.

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Kontributet, që paguajnë personat e punësuar në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, janë:

- a) 4 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të parë;
- b) 3 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji;
- c) 2 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjën “d” të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

- Tre paragrafët e parë riformulohen si më poshtë:

“Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 8 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen tri paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “b” të pikës 8 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i

largimit nga ky funksion.

Personave të grupit të dytë, që përmenden në shkrojnë "a" të pikës 9 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 40 për qind të pagës referuese, për atë kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion.”.

- Paragrafi i parafundit riformulohet si më poshtë:

“Në rastet kur përfituesi punësohet, brenda periudhës së përfitimit të pagave të funksionit të fundit apo të pagesës kalimtare, masa e pagesës mbi pagën e re është një kompensim deri në nivelin e pagës referuese të funksionit, por në çdo rast ajo nuk mund të jetë më shumë se paga e funksionit të fundit apo pagesa kalimtare e tij.”.

Neni 4

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“Personat, të cilët nuk plotësojnë periudhën e shërbimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, përfitojnë pension suplementar të reduktuar, në raport me periudhën e shërbimit në funksion apo në detyrë.”.

- Paragrafi i fundit shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

Pas shkronjës "b" të paragrafit të parë të shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) për personat e pikës 3 të nenit 8 të këtij ligji, 1 për qind e pagës referuese, për çdo muaj shërbim në funksionet e përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 8 të nenit 1 dhe 0,8 për qind e pagës referuese, për çdo muaj shërbimi në funksionet apo detyrat e përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 8 të nenit 1.”.

Neni 6

Në nenin 10 shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) pas arritjes së moshës për pension të plotë pleqërie ose para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 7

Në nenin 13, në paragrafin e parë, fjalët “e nenit 11” zëvendësohen me fjalët “e nenit 12”.

Neni 8

Në nenin 15, në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia:

“Periudhë shërbimi, për efekt përfitimi nga ky ligj, pas 1 prillit 1996, do të njihet periudha, gjatë së cilës është derdhur kontribut në fondin e sigurimit shtetëror suplementar.”.

Neni 9

Paragrafi i parë i nenit 17 ndryshohet si më poshtë:

“Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfutur nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë”, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese të funksionit.”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3828, datë 2.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**